

1

Ai ishte një qytet i larmë e i fuqishëm, i ndërtuar në rrafshirën midis detit dhe maleve, me shtëpi të ulëta e pallate shumëkatëshe, me vila moderne e shtëpi të kërrusura, të përziera pa rregull deri në lagjet periferike që i ngjiteshin shpatit të malit. Kushdo që vinte për herë të parë në atë qytet mahnitej me mjeshtërinë me të cilën dora e natyrës kishte gdhendur peizazhin e asaj visoreje me plazhe ranore e brigje shkëmbore. Në ditë të kthjellëta deti kishte një ngjyrë të ëmbël gurkali dhe në ditë të vrenjtura një syprinë të hirtë të shkumëzuar... por në çdo stinë ishte i bukur, me ca ishuj të kaltër në largësi. Kundruall detit, malet i rrinin qytetit si një kurorë e gjelbër.

Qyteti quhej Maldet dhe krahina Maldetanë. Gjuhëtarët e nxirmin prejardhjen e emrit nga bashkimi i emrave *mal* dhe *det* dhe në përforcim të tezës së tyre shtonin se edhe fjala Maldetanë do të thotë *nga anët e Maldetit*, por kishte dhe ndonjë që thoshte se vinte nga fjala italiane *maledetto*, (i mallkuar), që kushedi për ç'arsye ia kishin vënë, ndoshta që mundur ndonjë ushtri e tyre atje, çka s'mbështetej nga të tjerët.

Atë ditë maji të vitit 2004 kandidati i Partisë Popullore për postin e kryebashkiakut, Bedri Shahini, ishte në përfundim të fushatës së tij për zgjedhjet vendore që do të mbaheshin së shpejti.

Ashtu si në dy zgjedhjet e mëparshme, fushatën e zhvillonte agresive duke derdhur një lumë fondesh për tribuna, postera, flamuj, pankarta, banderola, ftesa, librushka, fletëpalosje, karburant, shërbime, hotele, dreka, darka, qerasje, shpërblime e një mori shpenzimesh të tjera. Si edhe më parë kapardisej i sigurt se do ta fitonte sërish mandatin, i treti radhazi, duke u ndier një lloj Bonaparti në politikë. Prej gjashtë vjetësh gëzonte simpatinë e një distrikti të madh që numëronte mbi 400 mijë votues.

Fatmiri bënte ecejake nëpër shesh dhe i vinte çudi se si njerëzit shfaqnin për politikanët të njëjtin entuzazëm si për artistët e skenës dhe të filmave, këngëtarët e rokut apo sportistët, dhe ndërpyetej se ç'ishte ajo që i tërhiqte tek ata, ku qëndronte magnetizmi i tyre, te premtimet apo se njeriu kishte qejf të vetëgënjehej? Gjatë viteve të kaluara në pushtet Bedriu s'kishte bërë kushedi çfarë, megjithatë populli e donte, e priste me brohoritje të shfrenuara daljen e tij në tribunë, ndoshta për meritë të vetë atij, sepse dinte të paraqitej në publik e në media si kampion i të drejtave të individit, i iniciativës së lirë, i një kapitalizmi me *fytyrë njeriu* e slogane të tilla... Kurse kundërshtari im i Partisë Kombëtare, buçiste në altoparlant zëri i tij

në atë miting madhështor, është me ide të vjetra... politikën e tij e përbën centralizmi, parimet utopiste, partia mbi pushtetin... kurse unë jam për pushtetin e popullit, për pushtetin tuaj... jam për balancimin e pushteteve, jo për mbajtjen e tyre në një dorë... Kjo është epoka e demokracisë... e lirisë... epoka e tiranisë vdiq... Kjo është kredoja ime... lufta ime kundër parimeve të mykura komuniste të diktatit dhe të mbytjes së lirive të individit...

I bërë derr duke dëgjuar çka kishte dëgjuar në çdo miting, Fatmiri vazhdonte të vinte vërdallë midis turmave që mbanin në duar lule, pankarta, banderola dhe bërtisnin si të çmendur, Madhori! Madhori! Rroftë sa malet Madhori!

Fatmiri vuri buzën në gaz kur dëgjoji atë fjalë që tashmë ishte bërë popullore dhe solli ndër mend historinë e saj. Në mandatin e kaluar, nga dashuria për epokën moderne të amerikanizimit të qytetërimit, Bedriu kishte vendosur t'i jepte përparësi mësimin të anglishtes në distrikt me synimin që, pas njëfarë kohe, ajo të bëhej gjuhë zyrtare. Shqipja e vjetër dhe e bukur, e ëmbla shqipe, do të braktisej, do ta flisnin vetëm të moshuarit, dhe kur ata do t'i linin lamtumirën kësaj bote, brezat pasardhës do të flisnin vetëm anglisht. Kjo do t'u hapte horizonte njerëzve, pasi do të kishin mundësi të komunikonin me gjithë botën dhe Bedriu do të hynte në analet e historisë si profeti i parë që e njohu më herët dobinë e kësaj nisme. Kështu, në një vendim të firmosur prej tij dhe të paapelueshëm prej askujt shpalli se qarku do të quhej *distrikt*, kurse ai vetë *major*, që në anglisht do të thotë kryebashkiak. Por meqë populli ende s'qe mësuar me anglishten dhe s'mund ta shqiptonte atë fjalë në mënyrë korrekte, mendoi ta thërrisnin *major*. Por duke qenë se major ishte gradë ushtarake dhe dashakeqët mund të hidhnin insinuata se distrikti qeverisej nga një ushtarak, i dha karar ta thërrisnin *madhor*, një hibrid i shqipes me anglishten që e jepte pak a shumë idenë lartësisë së ofiqit të tij.

Fatmiri s'pati pranuar të hipte në tribunë, s'donte të krijonte përshtypjen se anonte nga partia politike e Madhorit. Prej afro tre vjetësh ishte këshilltari i tij dhe do të ishte edhe për tre vjet, sepse Bedriu me siguri do të zgjidhej prapë. Me ato premtime, s'kishte si të mos zgjidhej. Edhe kur qe zgjedhur së pari, sot e gjashtë vjet më parë, të tilla premtime pati bërë. Atëhere Fatmiri kishte qenë prokuror dhe propaganda e fuqishme e Partisë Popullore i pati bërë jehonë mllëfit të njerëzve kundër firmave mashtruese piramidale, që ata i njëjtësuan me shtetin. Kyçi i fitores së Bedriut asokohe patën qenë premtimet për kthimin e parave të humbura në firma, që nuk qenë mbajtur, por populli shpresonte... ndaj ia kishte dhënë votat e prapë do t'ia jepte.

Papritur u dëgjua një sokëllimë e zgjatur, e çjerrë, e nervozuar dhe turma u tallazit. Nga mesi i saj dolën katër policë që hiqnin zvarrë një djalë të fuqishëm si ndonja 25 vjeç që përpiquej t'u shkëputej. Mashtron!, bërtiste djali. Ka 6 vjet në pushtet dhe mashtron! S'kemi drita, s'kemi ujë. Jemi 7 veta në shtëpi dhe rrimë pa u larë... Përpara shtëpisë sonë është një lavazh që lan tërë ditën e ditës makina me ujin e lagjes sonë... Ai është mashtrues... Merr përçindje nga lavazhi...

Një nga policët e goditi me shkop gome në kokë dhe djali rënkoj. Të tjerët vazhduan ta hiqnin zvarrë derisa u zhdukën përtej turmës. I mjeri ai, tha një plak me borsalinë. Do ta ngordhin në dru. Ç'i jep gojës? Sikur s'i dimë edhe ne këto gjëra. Po kemi gra, kalamanj...

Kaq tha plaku dhe ia mbathi me të shpejtë.

Turma ra fashë dhe zëri i folësit në tribunë buçiste po aq fort, sa më parë, i përcjellë nga altoparantët, Do të jetoni në begati...

Fatmiri iu afrua tribunës me një parandjenjë se midis gazetarëve dhe telereporterëve do të ishte ajo. E pa, ishte me fytyrë nga tribuna duke filmuar Bedriun që vazhdonte të çirrej, Do t'u japim dërmën skafistëve dhe kontrabandistëve... do ta dërrmojmë mafien... do të zhdukim kriminalitetin... do të hapim fabrika... parqe publike... mjedise çlodhëse për të moshuarit... kushte më të mira për romët...

Ajo uli kamerën, ktheu kokën rastësisht, pa Fatmirin dhe i buzëqeshi dhe ai mendoi se asaj i pëlqeu prania e tij dhe u ndërpyet se vallë a e merrte ajo me mend se ç'i ziente atij në shpirt? Një vajzë ndoshta e ka të vështirë të kuptojë se ç'tmerr dreqi krijon pamja e saj në shpirtin e djalit të cilit s'ka shumë që ajo i ka dhënë duart, mendoi ai. Kishin qenë të lidhur prej afro dy vjet e gjysmë, qysh kur Fatmiri kishte filluar punë në Ekzekutiv - kështu e quante bashkinë Madhori - si këshilltar i tij, ndërsa Alketa vazhdonte atje prej katër vjetësh si zëdhënëse shtypi e tij. Më parë kishte qenë gazetarë në televizionin *Morning Star*, ku pati nisur punën pasi që diplomuar në degën e gazetarisë, por Bedriu ia pati vënë syrin për ta marrë në Ekzekutiv dhe ajo kishte pranuar, se rroga ishte dyfish. Me Fatmirin kishin qenë kolegë vetëm për një vit, se më pas ajo që kthyer prapë në *Morning Star*.

Edhe pas ikjes së saj nga Ekzekutivi e kishin vazhduar lidhjen. Mirëpo rreth një muaj e gjysmë më parë, pas drekës që kishin ngrënë në një lokal të plazhit, ajo e kishte tronditur duke i thënë se s'ishte e denjë për të, se kishte pasur shumë histori dashurie e kësi profkash duke e nxjerrë kokën, më së fundi, se dashuronte një tjetër. Por teksa i bënte atë deklaram ndarjeje, ai pati vënë re se diçka nuk shkonte tek ajo, në qëndrimin e saj, në vështrimin e saj, në sytë e saj ku ai kishte pikasur një brengë të thellë. Sytë e saj, që ai i kishte parë në të gjitha

gjendjet e saj shpirtërore, kishin pasur një shkëlqim të atillë hidhërimi, sa atij i qe bërë të besonte se ai hidhërim do të mbushte edhe hapësirën rrotull tij dhe ai do të kaplohej si prej një avulli sulfuror që del nga disa të çara të dheut në kohë tërmeti.

S'i shqitej nga mendja pamja e saj kur ajo, pasi ia pati shtrënguar duart dridhshëm, qe larguar e ngashëryer pa e kthyer kokën pas. Ai vriste mendjen se ç'loj ndarjeje kishte qenë ajo, a thua se e kishte lënë ai, jo ajo. Ndërsa ai e kishte shoqëruar me sy tek ecte trotuarit, ajo qe përkulur mbi një djalë kokëbardhë si nja shtatë vjeç, e pati puthur në flokë, diçka i kishte dhënë, kishte qëndruar për pak sekonda mbi supet e tij, ndoshta e ngashëryer, derisa qe shkëputur dhe pati hipur në makinën e saj të bukur *Opel Corsa* në ngjyrë të kuqe...

U kthye sërish në realitet... e bëri zemrën gur, e kapi nga bërryli dhe me gojën te veshi i saj i bërtiti të shkonin të pinin gjësend. Kam punë, ia ktheu ajo, por sytë i qeshnin. Ai mendonte se ajo s'ishte nga ato femra që ish-të dashurin e barazojnë me një të huaj. As nuk kishte qejf që ajo ta quante mik, sepse e urrente nocionin e miqësisë midis mashkullit e femrës pas këputjes së dashurisë. Në të vërtetë ai s'gjente dot një përcaktor se cili ishte ai për të dhe ajo për të. S'qenë as të huaj, as miq, qenë thjesht ish-të dashur. Dy ura zjarri të shuara. Jo ai, ajo. Për të ajo vazhdonte të ishte po ajo që kishte qenë, një qenie tmerrësisht e dashur dhe që do t'i mungonte përjetë. Kjo ia shpellonte kraharorin si një kujë vajtimtare dhe sado që betohej se do t'i rrinte larg, s'e kishte në dorë ta mbante premtimin.

I kapi kamerën dhe ia përsëriti kërkesën. Në dreq fushata e Madhorit, i ulëriti, po ato gjëra llomotit. Ajo vuri buzën në gaz. Ai e kishte parë aq herë atë fytyrë, por atë çast ajo sepse iu duk si një burim drite me një magjepsje të veçantë, si një pikturë që krijon muzikë.

Ajo mbështeti kamerën në sup dhe eci pas tij. Ai mendoi se ajo do të kishte filmuar aq sa i duhej për emisionin e saj të mbrëmjes, ndryshe s'do të kishte ikur. I tha të hipnin në *Benz*-in e tij të vjetër, e kishte parkuar në Ekzekutiv dhe qenë afër, por ajo nguli këmbë të shkonin me makinën e saj, se s'mund ta linte në rrugë, kishte materiale në të. Teksa hipte, ai s'e pati në dorë të mos shihte parullat e mëdha në fasadën e Ekzekutivit të shkruara me të kuqe, me shkronja mbi një metër të larta: **DECENTRALIZIM, PËRPARIM, LULËZIM.**

Në anën e djathtë të rrugës *Lungomare* deti madhështonte si një pasqyrë vigane e valëzuar, e mbushur me një qetësi e zhurmëri të

njëkohshme që të krijonte ndjesinë se ndodheshe në pikëtakimin midis Tokës dhe misterit kozmik.

Shkuan në klubin *Korali i Kuq* ku qenë ulur kur ajo i kishte thënë *po* dashurisë së tij. Pamja e detit e mahniste si atëherë, aroma e leshterikëve dhe e jodit i dukej po aq ngacmuese dhe e dashur. Edhe lulet rreth klubit qenë si atëherë, edhe ajo e ulur përballë tij si atëherë. Sa më lodhin fushatat, i tha ajo. Të gjithëve, tha ai. Madhori më kërkon të kontrolloj qendrat e votimit, sikur s'ka një shtab të tërë për këtë. Pse shkon, atëherë? Ai e pa me habi. Si t'i them, nuk shkoj? S'ke bërë kështu ti kur ishe në Ekzekutiv? Sa herë të duash, i tha ajo. Më ka ngarkuar plot punë që s'më takonin. Po thashë se mos tani, që s'je më rishtar, do ta kundërshtoj për një punë që s'të takon. Unë s'guxoja. As unë, të them kot? Ti e di shumë mirë që s'e kam kundërshtuar kurrë. Atë askush s'guxon ta kundërshtojë, Fati. Sikur është ligji. Pse kështu?

Ai pikasi një lloj mllefi në tonin e saj. Kujt i hyn pushteti në gjak, e njëson veten me ligjin, Ketu. Por ai është edhe karizmatik. Di edhe të ta hajë kokën me të mirë, të fut në thes. Mbase ti, si femër, jep një mendim më të saktë për tipin e tij. Ajo u bë flakë dhe ai u hutua, s'e kuptoi arsyen e turbullimit të saj. Dihet, tha ajo, që ashtu është, karizmatik dhe autoritar. Pastaj heshti dhe vështroi nga deti. Ketu, të kam pyetur kaq herë, por gjithnjë më ke bërë bisht: pse ike nga Ekzekutivi? Është si është ai si pushtetar, si njeri s'është i keq, me të gjithë sillet mirë dhe rrogën ta trefishoi. Po, por rroga s'është gjithçka, ndihem më mirë në *Morning Star*. Kushedi bëj ndonjë dokumentar, gjej ndonjë sponsor, ka aq tema që dua t'i trajtoj. Ike se ndihesh më mirë në televizion? Jo për ndonjë arsye tjetër? Asaj iu err vështrimi dhe përsëri u skuq. Jo. Ç'arsye tjetër mund të kisha? Ai ndjeu se asaj iu drodh zëri dhe prapë shikoi nga deti. Ai s'ia ndante vështrimin fytyrës së saj, pastaj i uli sytë te duart. Të vogla, të bronzuara paksa nga dielli. Duart e saj. Sa herë ia kishte shtrënguar? Sa herë ia kishte puthur? I pëlqente t'ia puthte edhe kur bënin dashuri.

U afrua një djalë i vogël rom që shiste bajame në kaushë gazete. Fatmiri u bë gati ta përzinte, por ajo i ledhatoi flokët, nxori një monedhë nga çanta dhe bleu dy kaushë. Kur iku djali, ai e pyeti se ç'i kujtonin ato vende gjatë bregut. Kohë të vështira, tha ajo, luftërat mes bandave, plagosjen tënde... Lëri ato, Ketu. S'të duket se je si Xhoana te *Harku i Triumfit*? Verën e kaluar e kishin lexuar në të njëjtën kohë atë libër, leximi i dytë që kur e kishte blerë secili. Jo, tha ajo e zverdhur. Nuk ika nga ty për luksin... për paratë. Po nga Olsi pse? Ajo u pre dhe i ngeli luga me akullore përpara buzëve. Oh, Fati, për të më marrë në pyetje më solle këtu?

Ajo u përpoq të buzëqeshte si për t'i larguar një dyshim, por s'arriti ta vizatonte buzëqeshjen të plotë - ajo i doli e lodhur, si e trembur nga kujtimet. Ca gjëra do t'i mësosh me kohë, Fati. Ndonjë më mirë të mos e mësosh kurrë.

Ra zilja e celularit të saj dhe nga shprehja që i mori fytyra kur pa ekranin ai e mori me mend se duhej të ishte i dashuri i saj i ri. Ajo e ndërroi tonin e të folurit. Po, Edi. Jam te *Korali i Kuq* me një ish-koleg. Pauzë, rrudhosje e lehtë e ballit. Po, me të. Me Fatmirin, pra. Mirë ardhsh.

Fati, të vjen keq që ai do të vijë? e pyeti ajo duke futur telefonin në çantë. Po, Keti. Po paguaj e po iki. Jo! Po flas prapë me të e po i them të mos vijë. Jo, Keti, unë jam i tepërt. Por unë kam dëshirë të rrish. Ajo e kapi nga duart dhe iu drodhën buzët. Ai e pa i habitur dhe mendoi se s'po e kuptonte atë vajzë, pati kaluar shumë kohë me të dhe ende i kishte mbetur enigmë. Vështrimi i syve të saj e zbuti. Të lutem, Fati, kam shumë dëshirë të rrish.

Të dy i pllakosi heshtja si një re ku përflakeshin vetëtimat e kujtimeve. Tani ishte ai që i kapi dorën. Pse më ike, Keti? Ç'nuk shkonte tek unë? Fati, mos ma bëj më këtë pyetje, ma ke bërë kaq herë. Një ditë, ndoshta... Çfarë? Asgjë. Kthehu tek unë, Keti, le të jemi si më parë. Jo se po të lutem, por dua të kthehesh... me gjithë shpirt, me gjithë zemër. Jo, Fati. Dhe mos ma kërko më, mirë? Se do të zemërohem dhe s'do të pranoj më të pimë gjësendi bashkë, as të këmbëj më një fjalë me ty. As për punën? Ajo vuri buzën në gaz dhe në cep të syrit i ndrinte një pikë lot. Ç'buzëqeshje të mahnitshme ka, mendoi ai me brengë. Jo, për punën do të bisedojmë, se shefi yt s'bën dot pa televizionin tonë.

Shefi ua ka nevojën të tri televizioneve vendore, mendoi ai, por pa *Morning Star* vërtet s'bën dot, është i vetmi që i bën reklamë Ekzekutivit. Dy të tjerët i duhet t'i marrë me të mirë, sidomos *BlueSea Channel* që i shërben Partisë Kombëtare opozitare, ndonëse jo hapur.

- Keti, po iki. S'dua të më gjejë këtu.
- Unë erdha me ty. T'i them të mos vijë?
- Po e ktheve, s'do të mendojë mirë për ty tani që i the se je me mua.
- S'dua t'ia di. T'i them të mos vijë?
- Jo. Po paguaj e po iki, - tha ai dhe u ngrit. Ajo i kapi dorën.
- Rri edhe pak.
- S'dua të më gjejë këtu.
- Ai nuk ha njerëz.

Ai nuk ha njerëz, përsëriti Fatmiri me vete duke u ulur, por mua më duket se ai, edhe ti bashkë me të, më keni ngrënë zemrën dhe

kraharorin e ndiej bosh, një mazgallë të mbushur me pezme. Punë drejt, Keti. A të mori ai, a ike vetë, s'e di, por e përbuz veten time. E gjej kaq të kotë, kaq të poshtëruar. S'di nëse je ndier ndonjëherë kështu edhe ti.

Ajo mori frymë e lehtësuar dhe atij iu kujtua se atë vajzë e kishte parë për herë të parë përpara tetë vjetësh në ekranin e TV *Morning Star* ku ajo jepte lajmet e mbrëmjes dhe ai sapo kishte vënë këmbë në atë qytet. Ishte 19 vjeçe dhe i qe dukur yll dhe ai i ndiqte lajmet vetëm për të parë atë dhe kishte qenë një kohë që kishte besuar se e dashuronte tek e shihte në ekran. E kishte parë edhe në rrugë, një herë nga fare afër, kur ajo i kishte dalë papritur përballë me çantë shkolle në shpinë, ndoshta kur kishte qenë në vitin e dytë ose të tretë në universitet. E kishte parë edhe në plazh me bikini dhe i qe dukur mahnitëse dhe e paarritshme.

Por hera e parë që e kishte kundruar nga afër kishte qenë përpara katër vjetësh, gjatë procesit që ai pati zhvilluar kundër bandës së *Ujqve të Detit* dhe ajo kishte ndjekur thujtë çdo seancë duke shkruar me stenografi raportet që do t'ia relatonte Madhorit. Nuk njiheshin, kishin shkëmbyer vetëm disa batuta kalimthi dhe në një pushim ajo e pati ftuar për kafe. Ai qe habitur dhe e pati pyetur përse e ftonte. Më pëlqeve, i tha ajo, m'u duke si personazh filmi, s'e di, dhe kishte buzëqeshur në mënyrë enigmatike. Kurse në të vërtetë pirja e kafes kishte qenë thjesht një takim pune për hollësi rreth procesit që i duheshin asaj. S'di nëse edhe asaj i kujtohet kjo histori, u ndërpyet. Ajo kishte një të folur nazike me një timbër kumbues e të ëmbël. Ai qe ndier i ngacmuar si drejt, qe matur t'i kapte dorën, por s'kishte guxuar. Ai kishte dëgjuar se ajo dashurohej me Olsi Shahinin, yllin e rokut të qytetit, një djalosh tejet simpatik, djali i Madhorit. E njihnte Olsin për së largu, kishte parë disa nga koncertet e tij, e kishte parë edhe në televizionin vendor ku grupi i tij i rokut dilte shpesh. Por s'pati pasur guxim ta pyeste atë vajzë nëse kishte lidhje me ndonjë djalë. Më shumë e kishte munduar vramendja nëse duhej t'i kërkonte të takoheshin prapë, çka s'e pati bërë. Ajo e pati marrë edhe në telefon për ca hollësi të tjera lidhur me procesin, dhe vetëm kaq, kurse ai kishte dashur t'i kërkonte një takim, por s'kishte guxuar. Kur e dinte që ishte e zënë, si mund të guxonte? Veç kësaj, ajo bënte pjesë në elitën e qytetit, ishte figurë e njohur si nga televizioni, ashtu edhe nga posti që mbante në Ekzekutiv, frekuentonte lokale luksoze, shoqërohej me djem të pashëm, kurse ai s'ishte veçse një shkresëtar i thjeshtë, pa kurrfarë cilësie për të qenë i njohur, ndaj s'pati ushqyer shpresë se mund të afrohej me të. Ajo pati mbetur thjesht një mister,

një zanë natore me të cilën ai ngacmohej erotikisht në ëndrra dhe zgjohej duke mallkuar veten se përse s'i hiqte dot mendimet prej saj.

I kujtohej se kur qe ulur përballë saj, duke e pasur aq pranë, donte t'i gjente ndonjë të metë që në ekran s'ia kishte kapur dot, por kishte mbetur i magjepsur nga sytë e saj të zinj e të bukur. Fytyra e saj i qe dukur si një gur i çmuar i punuar për mrekulli nga dora e mistershme e krijimit. Kurse tani iu kujtua data 14 shkurt, dy vjet e ca më parë, kur ai i kishte thënë se e donte. Pikërisht ato ditë kur kishte dalë nga spitali.

Dashuria e parë me të... ai çelës magjik që më hapi portën e një kopshti të bukur dhe i vetmi që bëri të më shpërthente ai xhindi erotik që e mbaja të ndryrë si një fiksion obsesiv për të, vetëm për të. E kam ende atë ndjesi kur preka lëkurën e saj të brishtë dhe butësia nga mollëzat e gishtave m'u përvodh në zemër... dhe nuk filloja dot se kur më flakërinte më fort lumturia... te kënaqësia fizike apo te mendimi se po bëja dashuri me të dhe zemra më rrihte duke ma ngushtuar frymëmarrjen e duke më zgjeruar qenësinë dhe në mes të kofshëve të mia ndieja pulsimin e nxehtë të miseve të saj me forma të përkryera... dhe dashurinë e ndieja të zjarrtë edhe në lugth dhe të pacak në gjymtyrë si drita që ia sheh burimin por jo kufirin e përhapjes... dhe më pëlqente të isha i dhunshëm dhe ia ndukja fort me dhëmbë mjekrëzën dhe buzët dhe dhëmbët e mi hynin në mishin e sfungjertë të gjinjve të saj marramendës... dhe i kafshoja kofshët dhe e grija me thithje e kafshime në të gjithën e saj dhe shihja se dhuna i pëlqente dhe nisa të sendërgjoja forma të tjera dhune në atë dashuri të çmendur...

U shkund nga kujtimet, vështrimet e tyre u takuan dhe ai vuri re se ajo se si e shihte, me mall a me pendesë, s'e përcaktonte dot.

Njihesh me Edin? Jo, por e kam parë. Asaj i përpëliteshin qerpikët e ujësuar ndritshëm... Ndoshta e përmendi Edin për të përzënë një shpirt mundues brenda vetes, mendoj, dhe Edi është ai që ia ysht jashtë trupit. Një lloj zhdedemonizuesi. Sa mirë sikur të mos qeshë ngatërruar fare me të. La kitaristin e rokut për mua, një burokrat ligjesh e shkresash, si pasojë e një tërheqjeje fatalisht të papritur. Kurse për mua mrekullisht e bukur deri kur më la. Për milionat e Eduard Shkozës, pronarit të një autoservisi modern dhe të disa pikave të karburantit... që vetëm nga njëra nxjerr dhjetë herë më shumë se rroga ime.

Në oborrin e gjerë hyri *Porsche Carrera* e Eduard Shkozës, një veturë tejet luksoze, dhe ai zbriti. Trupgjatë, flokëverdhe, i hijshëm. I zunë sytë edhe Olsin në motorin e invalidit dhe u habit. Olsi i doli Edit përpara e se ç'i tha, ndoshta në lidhje me ndonjë problem të motorit.

Fatmiri s'e shihte fytyrën e Edit, por vetëm të Olsit, që fliste me rrëmbim. Pastaj Olsi i vuri marshin motorit dhe u largua.

Edi iu afrua tryezës me një buzëqeshje të gjerë, si duket e nxitur nga ngadhënjimi mbi dy ish-të dashurit e saj, apo ndoshta e lindur nga biseda e Olsit, që mund të mos kishte qenë për motorin. Të njëjtën buzëqeshje do të ketë edhe pasi të kem ikur unë, mendoi Fatmiri me pezm.

Alketa e njohu me Edin, i cili i dha dorën duke bërbelitur emrin e vet pa e ndarë nga fytyra atë buzëqeshje poshtëruese. Ç'idiot u tregova që ndenja, mendoi Fatmiri. Ajo e pyeti Edin se ç'i kishte thënë Olsi. E kishte fjalën për ty, Keti. Më pyeti, E fitove ti apo paratë e tua? Çuditë se si del tjetri nga parahistoria e më zë rrugën. Të ishte se këtë pyetje do të ma bënte ky zotëria, ndryshon puna. Unë s'pyes për gjëra që i di, ia ktheu Fatmiri dhe u ngrit. E ndjeu që kishte gënjyer, sepse sapo e kishte pyetur Alketën nëse ajo e kishte lënë për milionat e tij, por aq i bënte.